



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0035824-4, 5, /25 dt. 30.06.2025

Mitrovicë



Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020; nenin 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 30.06.2025, sjell këtë:

VENDIM

Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve

1. Miratohet Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.
 - 1.1 Ndryshohet pika 1. (një) nënpika 1.1 e vendimit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, në vend të anëtarit të Komisionit - Z. Lavdim Zeneli (i cili ka dhënë dorëheqje), Anëtare e Komisionit EMËROHET - Znj. Majlinda Kurti.
 - 1.2 Ndryshohet pika 1. (një) nënpika 1.4 e vendimit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, në vend të anëtares së Komisionit - Znj. Drita Kadriu (e cila ka dhënë dorëheqje), Anëtar i Komisionit EMËROHET - Z. Egzon Sadiku.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022 mbesin në fuqi.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.
4. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit



Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
 - 1 x 1 MAPL-së
 - 1 x 1 Arkivit
 - 1 x 1 Anëtarëve të emëruar
- Kopje: Kryetarit të Komunës




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022
Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 08.08.2022, pasi shqyrtoi Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve; sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve

- Me këtë vendim FORMOHET Komisioni për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve, në përbërje:
 - 1.1 Lavdim Zeneli
 - 1.2 Faruk Mujka
 - 1.3 Muhamet Hoti
 - 1.4 Drita Kadriu, dhe
 - 1.5 Drita Ibrahim.
- Detyrë e Komisionit të formuar me pikën 1 të këtij vendimi është shqyrtimi dhe vendosja në lidhje me të gjitha ankesat e paraqitura në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjet Publike Lokale, si dhe ankesat e paraqitura në procedurat e përzgjedhjes së zyrtarëve të NPL-ve, të parapara me nenin 21, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike.
- Komisioni i formuar për punën e tij do t'i raportojë me shkrim Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës për të gjitha çështjet e shqyrtuara.
- Komisioni për punën e tij kompensohet në harmoni me Vendimin e Kuvendit të Komunës për caktimin e pagave dhe kompensimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve.
- Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të Komisionit



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA